FEDERATA SHQIPTARE TAEKWONDO
Rruga: "Janosh Hunyadi", Pallati "Ana", Kati 4-rt,Tiranë, Shqipëri, Cel: 0692455100 E-mail: g_malko@yahoo.com; general.secretary@albaniantaekwondofederation.com

Tiranë, më 30.10.2026

Subject: Kërkesë për ofertë

From: Federata Shqiptare Taekwondo

Sigurimi i 6 biletave të avionit vajtje–ardhje Tiranë–Bukuresht–Tiranë, me siguracion shëndetësor të përfshirë

Federata Shqiptare e Taekwondo-së ju fton të paraqisni ofertën tuaj për sigurimin e 6 (gjashtë) biletave të avionit vajtje–ardhje dhe siguracionit shëndetësor për secilin udhëtar, për pjesëmarrjen në Kampionatin Evropian Kadet 2026 të Taekwondo-së, në Bukuresht, Rumani.

SPECIFIKIME TEKNIKE

1. Objekti i shërbimit

Sigurimi dhe lëshimi i 6 biletave të avionit vajtje–ardhje në itinerarin Tiranë–Bukuresht–Tiranë, si dhe i policave individuale të siguracionit shëndetësor të udhëtimit për të gjashtë personat.

2. Itinerari dhe datat e udhëtimit

• Nisja: nga Tirana, më 25 nëntor 2026. Mbërritja në Bukuresht duhet të jetë përpara orës 15:00, sipas orës lokale të Bukureshtit.

• Kthimi: nga Bukureshti në Tiranë, më 27 nëntor 2026.

• Numri i ndalesave: maksimumi 1 ndalesë në secilin drejtim; pranohen edhe fluturime direkte.

• Të gjashtë personat duhet të udhëtojnë në të njëjtat fluturime.

3. Siguracioni shëndetësor

Oferta duhet të përfshijë siguracion shëndetësor udhëtimi për secilin nga 6 personat, të vlefshëm në Rumani dhe në vendin e tranzitit, nëse ka, për të gjithë periudhën 25–27 nëntor 2026. Të specifikohen shoqëria e sigurimit, mbulimi, kufijtë e mbulimit dhe përjashtimet, përfshirë kushtet që lidhen me pjesëmarrjen në aktivitetin sportiv.

4. Përmbajtja e ofertës

Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

• Itinerarin e plotë të fluturimeve vajtje–ardhje, kompanitë ajrore, aeroportet, oraret lokale të nisjes e mbërritjes dhe kohëzgjatjen e ndalesës, nëse ka;

• Konfirmimin e disponueshmërisë për 6 persona në të njëjtat fluturime;

• Çmimin për person dhe çmimin total për 6 persona, me të gjitha taksat, tarifat e aeroportit, komisionet dhe siguracionin shëndetësor të përfshirë;

• Ndarjen e kostos së biletës dhe të siguracionit shëndetësor për person;

• Bagazhin e përfshirë në çmim, duke specifikuar bagazhin e dorës dhe bagazhin e regjistruar, peshën dhe përmasat e lejuara;

• Kushtet e rezervimit, pagesës, ndryshimit dhe anulimit të biletave, si dhe çdo kosto përkatëse;

• Afatin e vlefshmërisë së ofertës dhe afatin brenda të cilit duhet të konfirmohet rezervimi;

• Të dhënat identifikuese të operatorit ekonomik dhe kontaktin e personit përgjegjës.

5. Kërkesa të përgjithshme

Oferta duhet të përmbushë të gjitha kërkesat e mësipërme. Çdo shërbim shtesë ose kosto që nuk përfshihet në çmimin total duhet të deklarohet qartë në ofertë.

Pas konfirmimit nga Federata, operatori ekonomik duhet të lëshojë biletat elektronike dhe policat individuale të siguracionit shëndetësor. Të dhënat personale të udhëtarëve do të vihen në dispozicion nga Federata për realizimin e rezervimit dhe lëshimin e dokumenteve të udhëtimit.

6. Afati dhe mënyra e dorëzimit të ofertave

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave: më 01.11.2026,

Ofertat të dorëzohen në adresën elektronike: general.secretary@albaniantaekwondofederation.com ose pranë Federatës Shqiptare të Taekwondo-së.

Për Federatën Shqiptare të Taekwondo-së